



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës “Arkitekt Kasëmi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233140-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 244 520 (njëzetë e pesëmilion e dyqind e dyzetë e katërmijë e pesëqind e njëzetë) **lekë pa TVSH,**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, duke paraqitur ne te njejten kohe bilancin kontabel, se bashku me anekset e tij, si dhe çdo te dhene tjeter te percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji.”*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për dy vitet e fundit financiare (2021, 2022), që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 39, 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit e vlerëson të nevojshme kriterin për xhiron mesatare, dorëzimin e dokumentit përkatës vërtetimit ose pasqyrat financiare vjetore, pasi vërtetojnë kapacitetet ekonomike, financiare të operatorit ekonomik me qëllim përmbushjen dhe realizimin e kontratës. Kapaciteti pozitiv financiar i operatorit i dokumentuar me bilance apo pasqyra financiare për tre vite buxhetore i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë se tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Pasqyrat financiare me bilanc pozitiv dhe gjendja financiare bankare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri pozicionin financiar të operatorit ekonomik.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023.

***Shënim :** Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe :

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- Procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore si dhe :

- Situacionin përfundimtar të punimeve (për të vërtetuar natyrën e punës së kryer)
- Procesverbalin e kolaudimit (për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve)

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar, për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe
-

Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. Licenca profesionale

Operatori ekonomik ofertues, duhet të zotërojë licencë profesionale në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, e cila të përmbajë kategoritë si më poshtë:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- N.P – 1 A** Punime gërmimi në tokë
- N.P – A B** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- N.P – 7 A** Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike

PUNIME SPECIALE NË NDËRTIM

- N.S – 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S – 6 A** Sinjalistika rrugore jodriçuese

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me

licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.", VKM-së nr.759/2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim". Licencat janë të lidhura ngushtësisht me punimet e ndërtimit dhe projektin e zbatimit dhe Ligjit nr.10081 date 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

2.3.3. Staf i dhe punonjësit

A) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar drejtuesit teknik, që kanë në licencën e shoqërisë, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

| | |
|-------------------------|---------|
| – Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| – Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| – Inxhinier Elektrik | 1 (një) |

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Licencën profesionale dhe Cv.
- Listpagesën shoqërisë e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.
Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

B) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar në profesionet si më poshtë:

I. Specilistë ndërtimi

| | |
|---|-----------|
| – Teknik Ndërtimi | 1 (një) |
| – Hidraulikë | 1 (një) |
| – Elektricistë | 2 (dy) |
| – Hekurkthyes | 2 (dy) |
| – Saldator | 1 (një) |
| – Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to | 4 (katër) |
| – Bojaxhi | 2 (dy) |
| – Topograf | 1 (një) |

II. Drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni

- Drejtues i makinerive të rënda të ndërtimit 2 (dy)
- Eskavatorist 1 (një)
- Drejtues kamioni (autokamionist) me Leje drejtimi të tipi C 2 (dy)

Për specialistët e kërkuar më sipër të paraqiten diplomë/ dëshmi/ certifikatë/ ose çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimin e tyre si dhe kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, të paktën, për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Për drejtues të makinerive të rënda të ndërtimit dhe drejtues kamioni, të kërkuar më sipër të paraqiten: kontrata e punës, e vlefshme për të paktën, periudhën e parashikuar të realizimit të punimeve; Certifikatë Aftësimi Profesional për Përdoruesit e Makinerive të Rënda të Ndërtimit dhe Punimeve në Tokë nga DPSHTRR; Leje Drejtimi kategoria C me Certifikatë Aftësimi Profesional nga DPSHTRR për drejtuesi kamioni; si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të paktën për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave

- C) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër, të paktën, prej **40** (dyzet) punonjësish, përveç stafit drejtues menaxherial, të cilët duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:
- Listepagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e deklaruar.

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja c dhe ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku ky kriter lidhet ngushtësisht me objektin të kontratës *si dhe në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve*. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri një i inxhinierëve sipas profilit, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës dhe i bazuar në ligj, me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mire në kryerjen e punimeve, duke ju referuar objektit, vendndodhjes gjeografike. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast mund të çojë në mosrealizim në afat dhe me cilësi të dobët të punimeve. Personeli teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm për realizimin kontratës.

- D) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar punonjës të kualifikuar/çertifikuar, si dhe të figurojnë në listepagesat për tre muajt e fundit, si më poshtë:
- 1 (një) punonjës që të disponojnë certifikatë të trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.
 - 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga një organ i akredituar për dhënien e Ndihmës së Parë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Në mbështetje të ligjit Nr.10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe VKM-në Nr.312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier”,

si dhe Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar.

2.3.4. Mjetet dhe paisjet

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë mjetet dhe pasijet e nevojshme për realizimin në kohë dhe me sukses të punimeve, si më poshtë:

| | Paisje e makineri | Njësia | Sasia | Pronësia |
|----|---|---------------|--------------|------------------------|
| 1 | Makineri skarifikim shtresash | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 2 | Grejder | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 3 | Rul kompresor me vibrim | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 4 | Autobot uji | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 5 | Eskavator me goma 0.25m ³ | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 6 | Asfaltoshtruese | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 7 | Autobitumatrice | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 8 | Betoniere 500l, | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 9 | Vibrator thellesie betoni | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 10 | Vullkanizator, gur zmeril | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 11 | Kamione vetshkakues me kapacitet 10 ton | copë | 2 | Në pronësi ose me qera |
| 12 | Kamione vetshkakues me kapacitet 20 ton | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 13 | Makineri pastrimi me rere kuarci; | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 14 | Kompresor ajri; | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 15 | Sperkates boje per vizime ne rruge | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |
| 16 | Autovinç deri 5 ton | copë | 1 | Në pronësi ose me qera |

- a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - *dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, (çertifikata e pronësisë);*
 - *dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit);*
 - *çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
 - *siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
 - *leje transporti e vlefshme nga njësi vendore (sipas rastit)*
 - *foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij;*

- b. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

- c. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet :
 - kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse
 - fotot

d. Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë kur janë me qira, krahas dokumentacionit të mesipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plotë të punimeve.

***Shënim:** Në rastin kur fatura tatimore është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, ajo duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa është bazuar në pikën 4 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, pika 6, shkronja d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri është në përputhje me zërat dhe afatin e punimeve të parashikuara në preventivin dhe grafikun e punimeve. Gjithashtu është në përpjesitim me natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës. Operatorët ekonomik kërkesat për pajisjet në pronësi, mund ti plotësojnë edhe duke i marrë ato me qira. Lidhur me paisjet Autoriteti Kontraktor ka patur parasysh projektin, preventivin dhe relacionin teknik. Këto paisje mund të sigurohen lehtësisht nga operatori ekonomik pasi janë me kosto relativisht të ulët dhe nuk përbëjnë kriter diskriminues.

2.3.5. Kërkesat e cilësisë dhe standarteve

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vlefshme për periudhën e ndërtimit, si më poshtë **ose ekuivalente me to:**

| | |
|-----------------------------|------------------------------------|
| -Certifikate ISO 9001:2015 | (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) |
| -Certifikate ISO 14001:2015 | (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) |

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente), në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të punimeve duke qenë se objekti është i një rëndësie të veçantë. Ky kriter është në përpjesëtim me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

Shënim: Çertifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet të jene të leshuar nga Institucione të certifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në përputhje me shërbimet që ka marrë persiper në marrëveshjen e bashkepunimit.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaramentit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet Teknike

Objekti i prokurimit: **Rehabilitim urban në të dy anët e rrugës “Arkitekt Kasëmi”**, shoqërohet me projekt zbatim të plotë, relacion teknik, specifikime teknike, grafik punimesh dhe preventiv punimesh.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar projektin e hartuar nga “HTS COMPANY”, për rrjedhje edhe **Specifikimet Teknike**, në fazën e prokurimit të projektit.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni

78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur, punë.

Përfundime

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën e hapur, punë me objekt prokurimi **“Rikonstruksion i shkollës Ramis Aranitasi Çorovodë”**.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Ernest Ymeri

Jona Koçi